



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Bledar Çuçi – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të Komisionit të Integrimin European për periudhën 3-21 shtator 2018.
2. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integrimin European për projektligjin “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.
3. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Bledar Çuçi, Fatmir Velaj, Elisa Spiropali, Sadri Abazi, Musa Ulqini, Ilir Pendavinji, Taulant Balla, Arben Kamami, Klodiana Spahiu, Eglandina Gjermani, Andrea Marto.

Mungojnë:

Genc Pollo, Aldo Bumçi, Vangjel Dule, Grida Shqina (Duma), Jorida Tabaku, Klajda Gjoshaj, Viktor Tushaj,

HAPET MBLEDHJA

Bledar Çuçi – Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Integrimin European. Si fillim dua të shpreh keqardhjen për mungesën e opozitës në këtë komision kaq të rëndësishëm, të cilin ia kemi lënë ta drejtojë pikërisht opozita. Gjithsesi, jeta parlamentare vazhdon rregullisht, por i ftojme kolegët e opozitës të na bashkohen sa më shpejt për të miratuar ligje të rëndësishme, që lidhen me integrimin e Shqipërisë në Bashkimin European.

Sot për këtë shkak mbledhja do të drejtohet nga zëvendëskryetari i Komisionit për Integrimin European. Kuorumin e nevojshëm e kemi, ndaj e deklaroj të hapur mbledhjen.

Sot në rendin e ditës kemi dy çështje, së pari, miratimin e kalendarit të punimeve të Komisionit për Integrimin European për periudhën 3-21 shtator 2018 dhe, si pikë të dytë, kemi shqyrtimin e raportit të komisionit tonë për projektligjin “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe çështje të tjera, në qoftë se do të ketë diskutime jashtë rendit të ditës.

Pa humbur kohë, të gjithë kolegët e kanë marrë kalendarin e punimeve të komisionit edhe nëpërmjet postës elektronike, por e kanë edhe përpara.

Ka vërejtje lidhur me kalendarin e punës së komisionit? Kush është dakord për kalendarin për periudhën 3-21 shtator 2018? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me çështjen e dytë, shqyrtimin e raportit të Komisionit për Integrimin European për projektligjin “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.

Ju kujtoj, të nderuar kolegë, se kemi pasur një mbledhje ku kemi diskutuar për projektligjin në fjalë dhe për shkak të dy pikave, për të cilat nuk ramë dakord me përfaqësuesit e qeverisë, e shtymë miratimin e raportit për një datë tjetër. Tashmë edhe ato dy pika janë ezauruar, sepse kemi rënë dakord. Kështu që sot do të miratojmë raportin e komisionit tonë për projektligjin “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” për t’ia përcjellë komisionit përgjegjës, pastaj për ta kaluar në seancë plenare. Raporti u është dërguar të gjithë kolegëve nëpërmjet postës elektronike. Kështu, në qoftë se ndonjëri nga kolegët ka ndonjë opinion ose rekomandim lidhur me raportin, është i mirëpritur.

Ka pyetje? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Faleminderit, zoti drejtues i mbledhjes!

Në fakt, edhe unë dua të nënvizoj sadopak atë që thatë ju, rëndësinë që ka përfshirja e opozitës në përgjegjësinë që ka për drejtimin e Komisionit të Integritetit Europian, por edhe të Këshillit Kombëtar të Integritetit Europian, sepse, në fakt, në procesin parapërgatitor të hapjes së negociatave përfshirja e drejtpërdrejtë e Kuvendit të Shqipërisë në këtë proces është nëpërmjet këtyre dy strukturave të lartpërmendura (komisionit parlamentar ku ne bëjmë pjesë dhe Këshillit Kombëtar), të cilat ne ia kemi besuar opozitës.

Sigurisht, apeli, edhe si kryetar i grupit parlamentar të shumicës, është që, përtej angazhimeve politike apo axhendave të vogla politike, të paktën në këto dy organe të rëndësishme të Kuvendit, sikurse është Komisioni i Integritetit Europian dhe Këshilli Kombëtar i Integritetit Europian, opozita duhet t'i lejojë përfaqësuesit e saj të marrin pjesë.

Çështja e dytë që kam dhe që lidhet pikërisht me rendin e ditës është Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë. Gjatë muajve të verës, në mënyrë të përsëritur, shumë kompani ajrore kanë pasur probleme oraresh të papranueshme me shumë qytetarë shqiptarë ose të huaj, kryesisht emigrantët tanë që jetojnë në Itali kanë qenë më të dëmtuarit, për shkak të vonesave dhe anulimeve pafund të avionëve.

Më konkretisht, në nenet 138 dhe 140 të Kodit Ajror të Republikës së Shqipërisë, flitet qartë për të drejtat...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, këto janë dy nene që kanë qenë. Pra, këto dy nene flasin pikërisht për të drejtat e personave, të cilëve u refuzohet hipja në bord ose që duhet të kompensohen për fluturimin e tyre në një kohë të caktuar.

Ka pasur shumë qytetarë shqiptarë të cilët edhe ndaj nesh, si deputetë, kanë shprehur kritikën dhe shqetësimin e tyre. Prandaj unë mendoj që ne, si komision, Autoritetit të Aviacionit Civil, t'i kërkojmë me shkrim një shpjegim të të gjitha arsyeve pse kanë ndodhur këto vonesa, me qëllim që edhe ne të dimë t'i sqarojmë njerëzit, të cilët shpeshherë, edhe drejtpërdrejt, edhe nëpërmjet rrjeteve sociale, na shprehin shqetësimet e tyre, si dhe çfarë masash ka planifikuar qoftë Autoriteti, më së shumti Ministria e Infrastrukturës, që mbulon edhe pjesën e transportit, me qëllim që këto probleme të sqarohen dhe, më së shumti, atyre për të cilët ne kemi vëmendjen tonë, sepse e gjithë vëmendja jonë është te njerëzit, t'u japim përgjigje për çështjet që ata shqetësohen.

Bledar Çuçi – Faleminderit, zoti Balla!

I bashkohem shqetësimin tuaj e me këtë rast ftoj shërbimet e Kuvendit që të gjejnë mënyrën, rrugën ligjore se si duhet t'i adresohemi për shqetësimet që ngriti kolegu Balla, që pastaj ta çojmë përpara propozimin tuaj.

Ka diskutime të tjera në lidhje me raportin përfundimtar për Kodin Ajror? Nuk ka.

Atëherë, sipas praktikës dhe Rregullores së Kuvendit, hedhim në votë dokumentin që kemi përgatitur si komision, pra një opinion për projektligjin “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë” për t’ia vënë në dispozicion pastaj komisionit përgjegjës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, e drejtë, jo opinionin, por raportin e komisionit lidhur me projektligjin “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kaloi edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Lidhur me pikën “Çështje të tjera”, ka ndonjëri diçka tjetër? Nuk ka.

Duke ju falënderuar për pjesëmarrjen, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mbledhja e radhës do të njoftohet nga sekretaria e komisionit.

MBYLLET MBLEDHJA